

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

Ap. Nr. 130/2010

Data: 22 Gusht 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Kolegji prej tre gjyqtarësh i Gjykatës së Qarkut në Pejë, i përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Ingo RISCH si Kryetar i trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Dariusz SIELICKI dhe Gjyqtarja Vendore Elmaze SYKA si anëtarë të trupit gjykues, të ndihmuar nga Zyrtari Ligjor i EULEX-it Thomas FLANAGAN, në rastin penal kundër,

KOLE KRASNIQI, emri i babait Gjon, emri i nënës Gjyste, mbiemri i vajzërisë Skeli, i lindur me 24 Qershor 1950 në Nepole, numri i letërnjoftimit 1003357119, Shqiptar i Kosovës, aktualisht jeton në fshatin Nepole të Komunës së Pejës, i martuar, baba i 5 fëmijëve.

I dënuar me pesë (5) muaj burgim sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë P.nr. 685/09 i datës 05 Gusht 2010, për veprën penale të *Deklaratë e Rrejshme* në kundërshtim me Nenin 307 të KPK-së,

Duke vendosur në bazë të ankesës së të pandehurit, të parashtruar me datë 22 Tetor 2010, në seancën e mbajtur të hapur për publik, me 22 Gusht 2011, sipas Nenit 410, paragrafi 3 të KPPK-së, në mungesë të Prokurorit Publik dhe të pandehurit Kole Krasniqi, edhe pse që të dy ishin ftuar në mënyrë të rregullt

Pas votimit dhe shqyrtimit me datë 22 Gusht 2011, lëshon si në vijim

AKTGJYKIM

Ankesa e Kole Krasniqit ("Apeluesi") REFUZOHET si e pabazuar dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë P.nr. 685/09 i datës 08 Gusht 2010 me këtë KONFIRMOHET.

ARSYETIMI

1. Sfondi Procedural

Apeluesi ka parashtruar ankesë me gjykatën e Qarkut në Pejë në lidhje me vendimin e një gjyqtari të EULEX-it në Gjykatën Komunale në Pejë me datë 05 Gusht 2010 (Rasti numër P. Nr. 685/09). Shqyrtimet kryesore gjyqësore në Gjykatën Komunale ishin mbajtur me 14, 21 dhe 22 Korrik dhe me 05 Gusht 2010. Në ato data parashtruesi i ankesës (dhe i bashkakuzuari Gjergj Luli) ishin akuzuar me dhënien e Deklaratës së Rrejshme në kundërshtim me Nenin 307 të

KPK-së. Veprat penale ishin supozuar të kenë ndodhur me datë 31 Mars 2009 gjatë shqyrtimit kryesor të Gjeloš Krasniqit për veprat penale të krimeve të luftës. Gjyqtari i shkallës së Parë i ka dënuar që të dy Gjergj Lulin dhe Kole Krasniqin për veprën penale të Deklaratës së Rrejshme dhe e ka dënuar Gjergj Lulin për një periudhë kohore prej pesë muaj burgim me kusht dhe Kole Krasniqin për një periudhë prej pesë muajsh burgim të pakushtëzuar. Kole Krasniqi ka parashtruar një ankesë me datë 22 Tetor 2010.

2. Aktgjykimi i shkallës së Parë P.nr. 685/09

Parashtruesi i ankesës ka theksuar para mbajtjes së shqyrtimit kryesor se dëshmia që ai ka dhënë në gjykimin e Gjeloš Krasniqit me datë 31 Mars 2009, ka qenë e vërtetë. Në atë datë, ai ka theksuar se natën e 24 Marsit të vitit 1999 dhe në mëngjesin e 25 Marsit të vitit 1999 ai ka qenë prezent me Gjeloš Krasniqin dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së në shtëpinë e Pashk Krasniqit në fshatin Nepole. Ai ka deklaruar se ai ka qenë në komandë dhe se ai e ka caktuar Gjeloš Krasniqin me detyrat e kuzhinës dhe posaçërisht e ka udhëzuar atë që ta therte një viç në mënyrë që ta festonin faktin që kishin filluar bombardimet e NATO-s atë natë. Parashtruesit të ankesës nuk mund ti kujtohen emrat e ushtarëve tjerë prezent. Ai deklaroi se pas darkës, grupi (duke përfshirë edhe Gjeloš Krasniqin) ka qenë zgjuar duke festuar së bashku deri për afërsisht ora 7 të mëngjesit. Parashtruesi i ankesës ka theksuar më tej se ai ka shkuar në shtrat atëherë dhe se kur është zgjuar, Gjeloš Krasniqi nuk ka qenë më prezent. Parashtruesi i ankesës po ashtu ka theksuar se ai nuk e ka parë Gjeloš Krasniqin sërish e as që e ka bërë pyetje në lidhje me vendndodhjen e tij pavarësisht nga fakti se parashtruesi i ankesës ka qenë në komandë të UÇK-së në fshat. Pohimi se Gjeloš Krasniqi e kishte lëshuar fshatin ka qenë po ashtu i kundërshtuar nga dëshmitari i mbrojtjes. Parashtruesi i ankesës ka tentuar që ti portretizojë Gjykatës një kujtesë të qartë të ngjarjeve të natës në pyetje. Megjithatë, parashtruesi i ankesës ka rënë në kundërshtim me veten e tij në lidhje me shumë ngjarje të rëndësishme dhe sqarimet e tija kanë qenë thjesht të papranueshme. Ai e ka ditur që dëshmia që ai ka dhënë është e rrejshme dhe se ai ka gënjyer në mënyrë që të ofronte alibi të rrejshme për Gjeloš Krasniqin.

3. Ankesa

Gjykata e Shkallës së Dytë ka pranuar një parashtrësë me shkrim nga parashtruesi i ankesës me datë 18 Tetor 2010. Këto parashtrësë ishin ndarë në katër kategori kryesore mbi bazat ku secila prej tyre ishte e nën-ndarë në pika të shumta. Parashtruesi i ankesës ka parashtruar se Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur dispozitat e KPPK-së dhe KPK-së, ka nxjerrë përfundime të gabuara në lidhje me çështjet e fakteve dhe po ashtu ka keqpërdorur një numër të principeve tjera ligjore. Në mënyrë që të shmang përsëritjet Gjykata e Shkallës së Dytë i referohet përmbajtjes së ankesës.

4. Gjetjet e Gjykatës së Qarkut

a) Gjetjet faktike

Gjykata e Shkallës së Dytë ka gjetur së asnjëra nga argumentet e bëra nga parashtruesi i ankesës në lidhje me çështjet faktike nuk kanë qenë të mjaftueshme për ti rrëzuar gjetjet e Gjykatës së Shkallës së Parë. Gjykata e Shkallës së Dytë gjen se argumentet e parashtruesit të ankesës ishin të arsyetuara dobët, nuk i kanë adresuar gjetjet e Gjykatës Komunale në asnjë mënyrë materiale dhe kanë qenë përfundimisht jo bindëse. Gjykata e Shkallës së Dytë ka konfirmuar gjetjen e Gjykatës Komunale se si çështje faktike, me 31 Mars 2009, gjatë dhënies së dëshmisë gjatë gjykimit të Gjeloš Krasniqit, parashtruesi i ankesës Kole Krasniqi ka bërë deklaratë të rrejshme duke thënë se Gjeloš Krasniqi ka qenë me të në shtëpinë e Pashk Krasniqit në fshatin Nepole natën e 24 Marsit 1999 dhe mëngjesin e 25 Marsit 1999. Gjykata e Shkallës së Dytë po ashtu ka gjetur se në të vërtetë parashtruesi i ankesës Kole Krasniqi, e ka bërë deklaratën e tij në mënyrë që të ofrojë alibi të rrejshme për personin e akuzuar Gjeloš Krasniqi.

b) Gjetjet ligjore

Gjykata e Shkallës së Dytë ka ekzaminuar ankesën në lidhje me dispozitat e Nenit 415 paragrafi 1, (1) deri (4) të KPPK-së dhe ka gjetur se, në kundërshtim me parashtruesat e parashtruesit të ankesës, nuk ka pasur shkelje të dispozitave të Nenit 403, paragrafi 1, pika 12 apo Neni 403, paragrafi 2, pikat 1 dhe 2 të KPPK-së gjatë mbajtjes së shqyrtimit kryesor të parashtruesit të ankesës para Gjykatës së Shkallës së Parë.

Gjykata e Shkallës së Parë ka qenë e përbërë në mënyrë të duhur dhe gjyqtari i Shkallës së Parë nuk ka qenë i diskualifikuar.

Në lidhje me pikat e ndryshme të ankesës, gjykata e shkallës së dytë ndjek numërimin e njëpasnjëshëm të parashtruesit të ankesës në letrën e tij të ankesës së datës 18.10.2010 dhe gjen si në vijim:

1.

Sa i përket ankesës së parashtruesit të ankesës, se Neni 403 KPPK-së ishte shkelur, e kundërta është sqaruar tani, shikoni më lartë.

1.2

Sa i përket kërkesave të parashtruesit të ankesës, ai nuk ka dhënë deklaratë gjatë shqyrtimit të tij kryesor' përveç se pat pranuar se deklarata e tij e dhënë me 31 Mars 2009 ka qenë e vërtetë', Gjykata e Shkallës së Dytë gjen se deklarata e cila i referohet deklaratës së tij të mëhershme është po ashtu deklaratë në vete. Dhe meqë deklarata së cilës ai i referohej ishte e gabueshme, ai dha dëshmi të rrejshme duke e bërë këtë referencë, dhe deklarata e referuar përbënte po ashtu një deklaratë të gabuar.

1.3

Sa i përket parashtruesit të ankesës ai argumenton se ka dhënë vetëm një përshkrim të natës së 24.03.1999, ai mund ta interpretojë deklaratën e tij si një përshkrim, por pika vendimtare është se "përshkrimi" i tij që i gabuar

1.4.

Sa i përket çështjes që parashtruesi i ankesës e ka ngritur në mes të njësisë ushtarake dhe asaj civile, duke thënë që nuk është marrë në pyetje në lidhje me këtë çështje, argumentimi i tij është jo relevant, sepse deklarimi i gabuar ka qenë vetëm në lidhje me alibinë e gabueshme të cilën ai e ka dhënë. Llojet e uniformave të përdorura apo jo të përdorura, kanë qenë të parëndësishme kur bëhet fjalë për alibinë.

1.5.

Sa i përket çështjes që e ka ngritur parashtruesi i ankesës në lidhje me moshën e atyre personave të cilët nuk ishin në gjendje për të mbajtur armë, edhe ky aspekt në lidhje me alibinë e gabuar është po ashtu jo relevant.

1.6.

Pyetja e “ushtarëve të pa veshur me uniforma” të cilëve parashtruesi i ankesës u referohet, është po ashtu jo-relevante në lidhje me alibinë e tij të gabueshme.

1.7.

Në këtë pjesë të ankesës së tij, parashtruesi i ankesës përpiqet që ta mbroj veten e tij duke deklaruar se deklarata e tij ishte e mbështetur në të vërtetën dhe se Gjeloš Krasniqi ka qenë prezent në shtëpinë e Pashkut po atë natë, por Gjykata e Shkallës së Dytë gjen se e kundërta është dëshmuar dhe se alibia e tij ishte e gabueshme.

1.8.

Sa i përket asaj që parashtruesi i ankesës e merr në konsiderim se dëshmitarët e tjerë nuk janë gjetur fajtor sikurse ai, një argumentim i tillë është jo relevant, sepse Gjykata e Shkallës së Dytë ka për ta vlerësuar vetëm fajësinë e parashtruesit të ankesës.

2.

Për sa i përket asaj që parashtruesi i ankesës thekson vlerësim jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike, Gjykata e Shkallës së Dytë është e bindur se të gjitha kërkesat nga Neni 405 janë përmbushur.

2.1.

Përsëri në këtë pjesë të arsyetimit të ankesës së tij, parashtruesi i ankesës i referohet çështjes së uniformave. Siç është sqaruar tani në pikën 1.4, vetëm çështja e alibisë në vetë është vendimtare, jo çështja e uniformave.

2.2. Nën, nën-seksionin parashtruesi i ankesës sërish i referohet moshës së individëve të tjerë, edhe pse siç është sqaruar më lartë mosha është jo-relevante.

2.3. Derisa parashtruesi i ankesës e ka ngritur çështjen për ti kujtuar emrat e individëve specifik, kjo nuk ndikon në çështjen nëse alibia ka qenë e saktë apo e gabuar. Dhe për këtë arsye argumentimi i tij është jo-relevant.

2.4. Këtu parashtruesi i ankesës ka bërë dallim në mes të “ fillimit të darkës” dhe kohës “kur pjesëmarrësit e darkës kanë filluar për të ngrënë”. Kjo çështje është po ashtu e parëndësishme në lidhje me kualifikimin e alibisë që të jetë e gabuar.

2.5. Gjersa parashtruesi i ankesës sërish i referohet veshjes së uniformave, duhet që të shikohet si një përsëritje jo e rëndësishme e argumentimit të tij. Dhe Argumenti i mëtejme, ka pasur përshkrime të ndryshme në lidhje me kohën e fillimit dhe përfundimit të darkës, edhe kjo nuk është e rëndësishme sepse vetëm supozimi i alibisë duhet që të merret në konsideratë.

2.6. Sa i përket asaj që parashtruesi i ankesës ka konsideruar se dikush ndoshta është pirë dhe një fakt i tillë potencial nuk është diskutuar nga Gjykata, një argument i tillë është vetëm spekulativ pa ndonjë përmbajtje të rëndësishme. Aspekti kryesor nuk ishte pirja e alkoolit, por pyetja ku ka qenë Gjelosh Krasniqi prezent në kohën kur është kryer krimi.

2.7. Sa i përket pyetjes së bërë parashtruesit të ankesës, nëse ka funksionuar hierarkia brenda UÇK-së, nuk ka rëndësi sa i përket alibisë.

2.8. Sa i përket ankesës së parashtruesit të ankesës se në arsyetim dy deklarata ishin përmendur edhe pse ai pat bërë vetëm një referencë për deklaratën e tij të mëparshme, Gjykata e Shkallës së Dytë është dashur që sërish të vë në dukje se dëshmitari, i cili merret në pyetje nga ana e gjykatës dhe i referohet deklaratës së tij të mëparshme të dhënë, sikurse ka vepruar parashtruesi i ankesës, ai pastaj jep dëshmi të mëtejme.

4.

Nën këtë nën seksion parashtruesi i ankesës ka dështuar që të prezantojë argumente të mëtejme dhe thjesht kërkon një shfajësim, e cila sipas bindjes së Gjykatës së Shkallës së Dytë nuk mund që të lëshohet, sepse është përcaktuar fajësia e parashtruesit të ankesës.

Në lidhje me shkallën e dënimit, gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur arsye të mjaftueshme që ta zëvendësoj dënimin e shkallës së parë dhe ka vendosur sipas *detyrës zyrtare si në vijim*:

- a) Një dënim prej 5 muajsh burgim është brenda kornizave të ligjit dhe Gjykata e Shkallës së Dytë nuk e gjen këtë dënim që të jetë shumë i rëndë, sepse Neni 307 KPK-së parasheh një gjobë apo një dënim deri në një vit. Për ta dënuar me gjobë parashtruesin e ankesës apo që ti epet një dënim më i lehtë për më pak se 5 muaj burgim, nuk mund që të arsyetohet nga aspekti i qëllimit të dënimeve, sepse kjo nuk do ta pengonte kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen. Një zvogëlim i dënimit mund të merret nga ana e parashtruesit të ankesës si një ftesë që të vazhdojë me përsëritjen dhe dhënien e dëshmimeve të rrejshme në të ardhmen.
- b) Parashtruesi i ankesës po ashtu nuk e meriton një zvogëlim të dënimit duke urdhëruar një pezullim të shërbimit prej 5 muajsh burgim. Në lidhje me këtë Gjykata e Shkallës së Dytë është dashur që ta merr parasysh se Gjelosh Krasniqi ka qenë i akuzuar me krime të rënda të luftës dhe parashtruesi i ankesës, duke ofruar alibi të rrejshme, ka pasur për qëllim që të pengojë që i akuzuari të gjendet fajtor për krime aq të rënda.

Dhe në lidhje me qëllimet e mëtejme të dënimit, për ti penguar personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, shiko Nenin 34(2) të KPK-së, një dënim me kusht do të ishte një vendim i padrejtë, sepse gjykata, e cila në të shumtën e rasteve të procedurave penale, në masë të madhe mbështetet në dëshmitarë të besueshëm, do ti dërgonte një sinjal të gabueshëm publikut. Po ashtu edhe krahasimi me bashkë të akuzuarin e parashtruesit të ankesës, i cili ka pranuar një dënim me kusht, nuk do të shpije në një konsideratë tjetër, sepse deklarata e tij ka qenë e një rëndësie të vogël në krahasim me atë të parashtruesit të ankesës, i cili jo vetëm që ka dhënë deklaratë të rrejshme por ka shkuar edhe më tej dhe ka krijuar një alibi të rrejshme në përpjekje për ta mbrojtur Gjelosh Krasniqin.

Andaj është vendosur sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, AP.nr. 130/10 e datës 22 Gusht 2011

Anëtar i Panelit

Anëtar i Panelit

Anëtar i Panelit

Dariusz SIELICKI

Elmaze SYKA

İngö RISCH

